

**RREGULLORE**  
**PËR LLOJET DHE KARAKTERISTIKAT E MJETEVE TË CILAT I**  
**MBULOJNË PROVIGJONET TEKNIKE DHE MJETET TË CILAT E**  
**MBULOJNË PROVIGJONIN MATEMATIK, SI DHE PLASIM I**  
**DETAJUAR DHE KUFIZIM I KËTYRE INVESTIMEVE SI DHE**  
**VLERËSIMI I TYRE**

Në bazë të nenit 158-s, pika 1) dhe neni 74, pika 6) të Ligjit për Mbikëqyrje të Sigurimit ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë") nr. 27/02, 84/02, 98/02, 33/04, 88/05, 79/07, 08/D8, 88/08, 56/09, 67/10, 44/11 dhe 188/2013, 43/2014, 112/2014, 153/15, 192/15 dhe 23/16), Këshilli i Ekspertëve të Agjencisë për Mbikëqyrje të Sigurimit miratoi:

## **RREGULLORE<sup>1</sup>**

**për llojet dhe karakteristikat e mjeteve të cilat i mbulojnë provigjonet teknike dhe mjetet të cilat e mbulojnë provigjonin matematik, si dhe plasim i detajuar dhe kufizim i këtyre investimeve si dhe vlerësimi i tyre**

### **I. Dispozita të përgjithshme**

#### **Neni 1**

"Kjo rregullore përcakton rregullat për fondet që mbulojnë provigjonet teknike dhe mjetet që mbulojnë provigjonin matematikor, **si dhe shpërndarjen dhe kufizimin e detajuar të këtyre investimeve dhe vlerësimin e tyre** në shoqëritë e sigurimeve, pra shoqëritë e risigurimeve (në tekstin që vijon: shoqëria e sigurimeve), në pajtim me nenet nga 88 deri në 98 të Ligjit për Mbikëqyrjen e Sigurimeve (në tekstin që vijon Ligji), përkatësisht:

- parimet bazë të investimit,
- aktet e brendshme/interne të investimeve,
- llojet dhe karakteristikat e investimeve të lejuara,
- rregullat për shpërndarjen (lokalizimin) dhe kufizimin e investimeve,
- vlerësimin e aseteve/fondeve,
- formën dhe përmbajtjen e raporteve që shoqëritë e sigurimeve e përpilojnë për raportim dhe
- mënyrat dhe afatet e raportimit në Agjencinë e Mbikëqyrjes së Sigurimeve (në tekstin e mëtejshëm: Agjencia)."

### **II. Parime bazë të investimit**

#### **Neni 2**

(1) Shoqëria për sigurim është e detyruar t'i investojë mjetet të cilat i mbulojnë provigjonet teknike dhe provigjonin matematik në përputhje me rregullat dhe parimet e menaxhimit të kujdesshëm dhe të ndërgjegjshëm të investimeve.

(2) Gjatë zgjedhjes së llojit të investimeve të mjeteve të cilat i mbulojnë provigjonet teknike dhe provigjonin matematik, shoqëria për sigurim është e detyruar t'i marrë parasysh klasat në korniza

---

<sup>1</sup> Teksti i konsoliduar i Rregullores është hartuar në bazë të tekstit të Rregullores për llojet dhe karakteristikat e fondeve që mbulojnë provigjonet teknike dhe fondet që mbulojnë provigjonin matematik, si dhe shpërndarjen dhe kufizimin e detajuar të këtyre investimeve dhe vlerësimin e tyre ("Gazeta Zyrtare e RM-së" nr. 64/2011), Rregullores për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për llojet dhe karakteristikat e fondeve që mbulojnë provigjonet teknike dhe fondet që mbulojnë provigjonin matematik, si dhe shpërndarjen dhe kufizimin e detajuar të këtyre investimeve dhe vlerësimin e tyre ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 127/2014), Rregullores për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për llojet dhe karakteristikat e fondeve që mbulojnë provigjonet teknike dhe fondet që mbulojnë provigjonin matematik, si dhe shpërndarjen dhe kufizimin e detajuar të këtyre investimeve dhe vlerësimin e tyre ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 61/2016), Rregullores për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për llojet dhe karakteristikat e fondeve që mbulojnë provigjonet teknike dhe fondet që mbulojnë provigjonin matematik, si dhe shpërndarjen dhe kufizimin e detajuar të këtyre investimeve dhe vlerësimin e tyre ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 36/2019) dhe Rregullores për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për llojet dhe karakteristikat e fondeve që mbulojnë provigjonet teknike dhe fondet që mbulojnë provigjonin matematik, si dhe shpërndarjen dhe kufizimin e detajuar të këtyre investimeve dhe vlerësimin e tyre ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 118-2022). Teksti i konsoliduar nuk ka fuqi ligjore. Për qëllime ligjore janë të vlefshme vetëm tekstet e shpallura në Gazetat Zyrtare të sipërpërmendura.

të të cilave kryen veprimtari të sigurimit, duke i respektuar parimet e sigurisë, profitabilitetit dhe likuiditetit të investimeve, si dhe llojllojshmëri dhe shpërbërje të investimeve.

(3) Shoqëria për sigurim është e detyruar të përputhë afatin e maturimit të mjeteve të cilat i mbulojnë provigjonet teknike dhe provigjonin matematik me afatin e maturimit të obligimeve të cilat dalin nga kontratat për sigurim.

(4) Shoqëria për sigurim është e detyruar t'i përshtatë investimet e mjeteve të cilat e mbulojnë provigjonin matematik me të gjitha obligimet e saj të cilat dalin nga kontratat për sigurim, shumat e të cilave varen nga ndryshimet e kursit të devizës së valutave të huaja më së paku deri 80%.

(5) Shoqëria për sigurim është e detyruar të menaxhojë me investimet e mjeteve të cilat i mbulojnë provigjonet teknike dhe provigjonin teknik në mënyrë e cila siguron të ardhura adekuate dhe fluks me para të gatshme, që të mund në secilin moment t'i mbulojë dhe t'i shlyejë obligimet e maturuara, gjegjësisht mos ta vërë në pyetje azhurnimin e pagesës së kërkesave të dëmshpërblimit

(6) Shoqëria për sigurim nuk guxon t'i investojë mjetet të cilat i mbulojnë provigjonet teknike dhe provigjonin matematik në instrumente në të cilat janë të vendosura ndalime apo kufizime të cilit do lloj.

(7) Shoqëria për sigurim është e detyruar të investojë mjete në vlerë së paku të barabartë me vlerën e provigjoneve teknike neto.

(8) Nëse Agjencia vlerëson se shoqëria për sigurim i investon mjetet të cilat i mbulojnë provigjonet teknike dhe provigjonin matematik përkundër dispozitave nga paragrafi 1 deri në paragrafin 7 të këtij neni, mund t'i urdhërojë shoqërisë për sigurim të përputhet me dispozitat e Ligjit dhe të kësaj rregullore.

### **III. Akte të brendshme për investim Neni 3**

(1) Në kornizat e politikës për identifikim, matje dhe përcjellje të rreziqeve, shoqëria për sigurim është e detyruar të miratojë akte të brendshme për investimet me të cilat do t'i përcaktojë strategjitë dhe parimet e investimit, organizimit, veprimet, përcjelljen dhe raportimin për investimet.

Aktet e brendshme të cilat kanë të bëjnë me investimet duhet të përmbajnë:

- parime dhe qëllime të investimit,
- metoda të përcjelljes së investimeve, drejtimeve dhe mënyrave për zbatim të dispozitave ligjore dhe nënligjore,
- metoda të vlerësimit
- instruksione, kufizime, vlerësime të lejuara të vërtetuara në bazë të vlerësimit individual të rrezikut,
- përshkrim i procedurave të investimeve,
- strukturë organizative: definim i detyrave, kompetencave dhe përgjegjësi për njësitë organizative,
- përshkrim i detyrave të personave kompetentë për investim,
- ekspertizë dhe kualifikime të personave përgjegjës për investimin e mjeteve,
- raportim i brendshëm ndërmjet njësive organizative dhe afate të raportimit,
- mbikëqyrje dhe kontroll i procedurave të investimit, gjegjësisht vendosje e mekanizmave të brendshme kontrolluese që të sigurohet njohje e hershme e rrezikut potencial dhe vërtetimi i rrezikut, si dhe masa për ndalimin e llojeve të caktuara të rreziqeve, apo akumulim i rreziqeve me rëndësi më të madhe, dhe
- rregulla për organizim, ruajtje dhe aksesin e dokumentacionit kontabilist dhe dokumentacionit tjetër të lidhur me investimet e mjeteve.
- 

(2) Shoqëria e sigurimeve zbaton politikën e investimeve nëpërmjet vendosjes, gjegjësisht përputhjes së strukturës së tyre organizative.

(3) Aktet e brendshme për investim të mjeteve të shoqërive për sigurim duhet të përputhen me të gjitha rregullat në fuqi, gjegjësisht ligjet me të cilat rregullohen investimet.

### **IV. Lloje dhe karakteristika të investimeve të lejuara të mjeteve të cilat i mbulojnë provigjonet teknike dhe mjetet të cilat e mbulojnë provigjonin matematik**

#### **Neni 4**

(1) Shoqëria për sigurim është detyruar t'i investojë mjetet të cilat i mbulojnë provigjonet teknike dhe provigjonin matematik ekskluzivisht në llojet e investimeve të përcaktuara në Ligj.

(2) "Përveç dispozitave të paragrafit (1) të këtij neni, dhe në pajtim me dispozitat e nenit 88 paragrafi (1) pika 16) të Ligjit, si fonde të lejuara që mbulojnë provigjonet teknike dhe provigjonin matematik të shoqërisë së sigurimeve konsiderohen edhe avanset e dhëna në masën e vlerës së shlyerjes së policës së sigurimit të jetës, deri në 20% të vlerës neto të provigjonit matematik.

3) Kur investohen fonde që mbulojnë provigjonet teknike dhe provigjonin matematik, shoqëritë e sigurimeve janë të detyruara të respektojnë kufizimet e parashikuara në ligj dhe në këtë rregullore.

#### **Neni 5**

(1) Mjetet të cilat i mbulojnë provigjonet teknike dhe provigjonin matematik mund të investohet në depozitat në banka të cilat kanë leje të dhënë nga Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut në përputhje me nenin 88 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit, më së shumti deri 25% nga vlera e plotë e mjeteve të cilat i mbulojnë provigjonet teknike, gjegjësisht provigjonin matematik në bankë individuale.

#### **Neni 6**

(1) Mjetet të cilat i mbulojnë provigjonet teknike dhe provigjonin matematik, mund të investojnë në obligacione dhe në letra të tjera debitoare me vlerë në përputhje me nenin 88 paragrafi (1) pika 6) e Ligjit, nëse:

- Obligacionet, gjegjësisht letrat e tjera debitoare me vlerë janë të botuara prej shoqërive aksionare të vendit në bazë të miratimit nga ana e Komisionit të Letrave me Vlerë të Republikës së Maqedonisë së veriut (në tekstin e mëtejshëm: KLV)
- Obligacionet, gjegjësisht letrat e tjera debitoare me vlerë kuotojnë në tregun zyrtar të bursës së letrave me vlerë apo treg tjetër i organizuar të letrave me vlerë në Republikën e Maqedonisë së Veriut të cilin e kontrollon KLV, dhe
- shoqëritë aksionare të cilat i botojnë kanë raport për auditim të kryer të raporteve vjetore financiare në të cilin nuk është shprehur distancim nga mendimi apo mendimi negativ për vitin e fundit financiar, në përputhje me standardet ndërkombëtare për auditim, dhe i cili është i punuar nga shoqëria e autorizuar për auditim.

#### **Neni 7**

(1) Mjetet të cilat i mbulojnë provigjonet teknike dhe provigjonin matematik mund të investohen në obligacione dhe letra tjera debitoare me vlerë në përputhje me nenin 88 paragrafi (1) pika 7) të Ligjit, nëse shoqëritë aksionare të cilat i botojnë kanë raport për auditim të kryer të raporteve vjetore financiare te i cili nuk është shprehur përmbajtje nga mendimi apo mendimi negativ për vitin e fundit financiar, në përputhje me standardet ndërkombëtare për auditim, dhe i cili është punuar nga shoqëria e autorizuar për auditim.

#### **Neni 8**

Mjetet të cilat i mbulojnë provigjonet teknike dhe provigjonin matematik mund të investohen në aksione në përputhje me nenin 88 paragrafi (1) pika 8) të Ligjit nëse:

aksionet janë botuar prej shoqërive aksionare të vendit në bazë të pëlqimit nga KLV,

aksionet kuotojnë në tregun zyrtar apo tregtojnë në tregun e shoqërive aksionare me obligime të veçanta për raportim në kornizat e tregut të rregullt të bursës së letrave me vlerë apo në treg tjetër të organizuar të letrave me vlerë në Republikën e Maqedonisë së Veriut të cilin e kontrollon KLV, dhe

shoqëritë aksionare të cilat i botojnë kanë raport për auditim të kryer të raporteve vjetore financiare ku nuk është shprehur distancim nga mendimi apo mendimi negativ për vitin e fundit financiar, në përputhje me standardet ndërkombëtare për auditim, dhe i cili është i përpiluar prej shoqërisë së autorizuar për auditim.

### **Neni 9**

(1) Mjetet të cilat i mbulojnë provigjonet teknike dhe provigjonin matematik mund të investohen në aksione në përputhje me nenin 88 paragrafi (1) pika 9) të Ligjit, nëse shoqëritë aksionare të cilat i emitojnë kanë raport për auditim të kryer të raporteve vjetore financiare ku nuk është shprehur përmbajtje nga mendimi apo mendimi negativ për vitin e fundit financiar, në përputhje me standardet ndërkombëtare për auditim, dhe i cili është i përpiluar prej shoqërisë së autorizuar për auditim.

### **Neni 10**

(1) Mjetet të cilat i mbulojnë provigjonet teknike dhe provigjonin matematik mund të investohen në aksione në shoqëri tregtare në përputhje me nenin 88 paragrafi (1) pika 10) të Ligjit, nëse kemi të bëjmë me shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me seli në R. e Maqedonisë së veriut.

(2) Në shoqëri me përgjegjësi të kufizuar nga paragrafi 1 të këtij neni mund të investohet ekskluzivisht nëse nuk janë persona të lidhur me shoqëritë për sigurim.

### **Neni 11**

(1) Mjetet të cilat i mbulojnë provigjonet teknike dhe provigjonin matematik mund të investohen më së shumti deri 10% në pjesëmarrje dhe aksione të fondeve të hapura dhe të mbyllura investuese në përputhje me nenin 88 paragrafi (1) pika 11) të Ligjit, të botuara nga shoqëria e njëjtë për menaxhim me fondet investuese të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

(2) Në pjesëmarrje në fonde private investuese mund të investohen më së shumti deri 1,5% të mjeteve të cilat i mbulojnë provigjonet teknike dhe provigjonin matematik, me çka në fond individual investues mund të investohen më së shumti deri 0,5% nga mjetet të cilat i mbulojnë provigjonet teknike dhe provigjonin matematik.

### **Neni 12**

(1) Mjetet të cilat i mbulojnë provigjonet teknike dhe provigjonin matematik mund të investohen në obligacione afatgjate dhe letra debitore afatgjate me vlerë në përputhje me ligjin 88 paragrafi (1) pika 12) të Ligjit, nëse shteti që ka emituar obligacionet dhe letrat e tjera me vlerë ka vlerësim kreditor afatgjat për obligim në valutë të huaj "BBB+" apo vlerësim më të lartë sipas Fitch Investor Services apo Standard & Poor's apo „Baa1" apo më të lartë sipas Moody's.

### **Neni 13**

(1) Mjetet të cilat i mbulojnë provigjonet teknike dhe provigjonin matematik mund të investohen në obligacione afatgjate dhe letra debitore afatgjate me vlerë në përputhje me ligjin 88 paragrafi (1) pika 13) të Ligjit, nëse:

a) letrat debitore me vlerë kanë vlerësim kreditor të dhënë nga së paku një agjenci ndërkombëtare kreditore e vlerësimit, dhe atë: "BBB+" apo vlerësim më të lartë sipas Fitch Investor Services apo Standard & Poor's apo „Baa1" apo më të lartë sipas Moody's për instrumente afatgjate, dhe

b) shteti i emitimit të obligacioneve dhe letrave të tjera me vlerë ka vlerësim kreditor afatgjatë për obligim në valutë të huaj "BBB+" apo vlerësim më të lartë sipas Fitch Investor Services apo Standard & Poor's apo „Baa1" apo më të lartë sipas Moody's.

### **Neni 14**

(1) Mjetet të cilat i mbulojnë provigjonet teknike dhe provigjinin matematik mund të investohen në aksione emituesi i të cilave është shoqëri e huaj aksionare në përputhje me nenin 88 paragrafi (1) pika 14) të Ligjit, nëse shoqëritë aksionare të cilat i emitojnë i përmbushin kushtet në vijim:

a) vlerësimi kreditor (issuer rating) i kompanisë emitues është "BBB+" apo vlerësim më i lartë sipas Fitch Investor Services apo Standard & Poor's apo „Baa1" apo më të lartë sipas Moody's, dhe

b) shteti në të cilin gjendet selia e emituesit të aksioneve ka vlerësim afatgjatë kreditor për obligim në valutë të huaj "BBB+" apo vlerësim më të lartë sipas Fitch Investor Services apo Standard & Poor's apo „Baa1" apo më të lartë sipas Moody's.

#### **Neni 15**

(1) Mjetet të cilat i mbulojnë provigjonet teknike dhe provigjonin matematik mund të investohen në aksione në fonde investuese në përputhje me nenin 88 paragrafi (1) pika 10) të Ligjit, nëse:

a) shoqëria për menaxhim të fondeve investuese është me seli në shtet anëtar të BE-së apo OECD-së, me çka selia nuk guxon të jetë në zonë off-shore të caktuar nga Fondi Ndërkombëtar Monetar, dhe

b) fondi i huaj investues është i regjistruar në shtet i cili ka vlerësim afatgjatë kreditor për obligim të huaj në valutë të huaj "BBB+" apo vlerësim më të lartë sipas Fitch Investor Services apo Standard & Poor's apo „Baa1" apo më të lartë sipas Moody's, dhe

c) fondi i huaj investues nuk ka karakteristika të hexh fond (hedge fund), gjegjësisht fond privat me kapital të rrezikshëm.

### **V. Kontrata Fjuçers, opsione dhe instrumente të tjera të derivateve financiare**

#### **Neni 16**

(1) Shoqëria e sigurimeve mund të përdorë kontrata fjuçers, opsione dhe instrumente të tjera të derivateve financiare nëse ato mundësojnë sigurim nga rreziqet e ndodhura si rezultat i fluktacioneve të kursit të devizës, normave të interesit dhe lloje të tjera të rreziqeve të tregut.

(2) Para se të fillojë të përdorë instrumente derivate financiare, shoqëria e sigurimeve është e detyruar të përpilojë akte të brendshme për përdorim të instrumenteve të derivateve financiare, me të cilat do ta përcaktojë mënyrën e matjes dhe menaxhimit me rreziqet në të cilat janë të ekspozuara mjetet të cilat i mbulojnë provigjonet teknike dhe provigjonin matematik.

(3) Shoqëria e sigurimeve është e detyruar ta raportojë Agjencinë për përdorimin e instrumenteve të derivateve financiare, në afat prej 8 ditëve pas mbarimit të muajit.

### **VI. Vlerësim i investimeve**

#### **Neni 17**

Llojet e investimeve të parashikuara në këtë Ligji dhe në këtë rregullore do të vlerësohen në përputhje me Standardet ndërkombëtare për raportim financiar dhe Rregulloren për metodën e vlerësimit të normave të bilancit të gjendjes dhe përgatitje të bilanceve të punës.

### **VII. Raportet**

#### **Neni 18**

(1) Shoqëria e sigurimeve është e detyruar të përpilojë raportet tremujore në vijim:

1. Raport mbi investimin e fondeve që mbulojnë provigjonet teknike (VTR), i
2. Raport mbi investimin e fondeve që mbulojnë provigjonin matematik (VMR).

(2) Shoqëria e sigurimeve është e obliguar që raportet nga paragrafi (1) i këtij neni t'i përpilojë në përputhje me formën dhe përmbajtjen e tyre, të përcaktuara me formularët VTR dhe VMR, të cilat janë dhënë në shtojcën 1 të kësaj rregulloreje dhe janë pjesë përbërëse e saj.

(3) Në rast se shoqëria e sigurimit formon disa fonde të mjeteve që mbulojnë provigjonin matematik, shoqëria e sigurimeve është e detyruar të njoftojë Agjencinë individualisht për investimet që mbulojnë provigjonin matematikor për çdo fond veç e veç, duke shënuar çdo formular VMR. me një numër numerik (VMR-1, VMR-2, etj.)

(4) Shoqëria e sigurimeve është e obliguar që raportet nga paragrafi (1) i këtij neni t'i përpilojë në përputhje me udhëzimet për plotësimin e raporteve për investimin e fondeve që mbulojnë provigjonet teknike dhe provigjonin matematik, të cilat janë dhënë në aneksin 2 të kësaj Rregulloreje dhe janë pjesë përbërëse e tij.

(5) Të gjitha shumat në raporte janë të shprehura në denarë maqedonas."

### **VIII. Mënyra dhe afate të raportimit**

#### **Neni 19**

(1) "Shoqëria e sigurimit është e obliguar t'i dorëzojë Agjencisë raportet nga neni 18 paragrafi (1) të kësaj rregulloreje për bilncin me 31 mars (tremujori i parë), 30 qershor (tremujori i dytë), 30 shtator (tremujori i tretë) dhe 31 dhjetor të vitit aktual (tremujori i katërt), në një afat brenda 30 ditëve nga përfundimi i tremujorit të cilit i referohet raportimi".

(2) Me përjashtim të paragrafit 1 të këtij neni, shoqëria për sigurim është e detyruar ta raportojë Agjencinë për tremujorin e katërt dhe shtesë me dorëzimin e raporteve vjetore financiare.

(3) Shoqëria e sigurimeve i dorëzon formularët e plotësuar me rregull IPT dhe IPM në formë elektronike në mënyrë të përcaktuar nga ana e Agjencisë për Mbikëqyrje të Sigurimit.

(4) Nëse ulet vlerësimit kreditor për emituesin apo për letrën me vlerë nën nivelin e lejuar, shoqëria e sigurimit është e detyruar që për këtë ta raportojë Agjencinë në afat prej 8 ditëve nga ulja e vlerësimit kreditor për emituesin apo letrën me vlerë nën nivelin e lejuar, dhe të përputhet në afat prej 90 ditëve nga dita e bërjes së këtij ndryshimi.

(5) Nëse shoqëria e sigurimeve ka leje nga Agjencia për transferim të aktiviteteve të jashtme të lidhura me menaxhimin e mjeteve të cilat i mbulojnë provigjonet teknike dhe provigjonin matematik, shoqëria e sigurimit është e detyruar së bashku me raportimin e paragrafëve 1 dhe 3 të këtij neni të dorëzojë edhe dokumentacionin e plotë në lidhje me aktivitetet aktuale të cilat kanë të bëjnë me investimet.

### **VIII. Dispozita kalimtare dhe përfundimtare**

#### **Neni 19**

**(Neni 19 nga Rregullorja për llojet dhe karakteristikat e mjeteve të cilat i mbulojnë provigjonet teknike dhe mjetet të cilat e mbulojnë provigjonin matematik, si dhe plasim i detajuar dhe kufizim i këtyre investimeve si dhe vlerësimi i botuar në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë" nr. 64/2011)**

(1) Dispozitat e nenit 4 paragrafi 1 pika 2.2 të kësaj rregullore do të aplikohen deri më 31.12.2011.

(2) Dispozitat e nenit 4 paragrafi 1 pika 2.3 të kësaj rregullore do të aplikohen nga 01.01.2011 deri më 31.12.2012.

#### **Neni 20**

**(Neni 20 nga Rregullorja për llojet dhe karakteristikat e mjeteve të cilat i mbulojnë provigjonet teknike dhe mjetet të cilat e mbulojnë provigjonin matematik, si dhe plasim i detajuar dhe kufizim i këtyre investimeve si dhe vlerësimi i botuar në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë" nr. 64/2011)**



(1) Kjo rregullore hyn në fuqi me ditën e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë", ndërsa do të fillojë të aplikohet gjatë përgatitjes së raportimit për llojet e investimeve të mjeteve të cilat i mbulojnë provigjonet teknike dhe mjetet të cilat e mbulojnë provigjonin teknik dhe raporti vjetor i shoqërive të sigurimeve me gjendje të 30 qershorit viti 2011.

#### **Neni 21**

**(Neni 3 nga Rregullorja për llojet dhe karakteristikat e mjeteve të cilat i mbulojnë provigjonet teknike dhe mjetet të cilat e mbulojnë provigjonin matematik, si dhe plasim i detajuar dhe kufizim i këtyre investimeve si dhe vlerësimi i botuar në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë" nr. 127/2014)**

6

Tekst i korigjuar jozyrtar

(1) Kjo rregullore hyn në fuqi me ditën e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".

(2) Shoqëritë janë të detyruara ta aplikojnë këtë rregullore me përgatitjen e raporteve tremujore për tremujorin e tretë të vitit 2014.

#### **Neni 22**

**(Neni 9 nga Rregullorja për ndryshim dhe plotësim të Rregullores për llojet dhe karakteristikat e mjeteve të cilat i mbulojnë provigjonet teknike dhe mjetet të cilat e mbulojnë provigjonin matematik, si dhe plasim i detajuar dhe kufizim i këtyre investimeve si dhe vlerësimi i botuar në "Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë" nr. 61/2016)**

(1) Kjo rregullore hyn në fuqi me ditën e botimit në "Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë", ndërsa do të aplikohet nga 1 prilli i viti 2016.

(2) Shoqëritë janë të detyruara ta aplikojnë këtë rregullore me përgatitjen e raporteve tremujore për tremujorin e dytë të vitit 2016.

**Neni 12 i Rregullores për llojet dhe karakteristikat e fondeve që mbulojnë provigjonet teknike dhe fondet që mbulojnë provigjonet matematike, si dhe shpërndarjen dhe kufizimin e detajuar të atyre investimeve dhe vlerësimin e tyre ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 36/2019 )**

(1) Kjo rregullore hyn në fuqi me ditën e shpalljes në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".

(2) Shoqëritë janë të detyruara ta zbatojnë këtë rregullore gjatë përpilimit të raporteve për tremujorin e parë të vitit 2019.

**Neni 11 i Rregullores për llojet dhe karakteristikat e fondeve që mbulojnë provigjonet teknike dhe fondet që mbulojnë provigjonet matematike, si dhe shpërndarjen dhe kufizimin e detajuar të atyre investimeve dhe vlerësimin e tyre ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 118/2022)**

Kjo rregullore hyn në fuqi një ditë pas shpalljes në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut" dhe do të fillojë të zbatohet në përpilimin e raportit për llojet e investimeve të mjeteve që mbulojnë provigjonet teknike dhe fondet që mbulojnë provigjonin matematik me bilancin e 30 qershorit të vitit 2022.

**Kryetar i Këshillit të Ekspertëve**

**Kërste Shajnoski**

**ПРИЛОГ 1/ АНЕКСИ 1**

**Извештај за вложување на средствата кои ги покриваат техничките резерви - Образец ВТР/ Raport mbi investimin e фондеве që mbulojnë provigjonet teknike - Formulari VTR/**

(назив на друштво)/emri i shoqërisë

(период)/periudha

(тековна година)/viti aktual

ВТР: Вложувања на средствата кои ги покриваат техничките резерви

VTR: Raport mbi investimin e фондеве që mbulojnë provigjonet teknike

МКД/  
МКД

	Број Num ër	Дозволен / E lejuar %	Остварен износ/ Shumë e realizuar			Остварен / E realizuar %%
			ВТР	Вкупно ВМР	ВТР + Вкупно ВМР	
		1	2	3	4	5
<b>Видови дозволени вложувања/ Lloje të investimeve të lejuara</b>	<b>I</b>					
Парични средства во благајна и средства на банкарските сметки/ Mjete të hollash në arkë dhe mjete të llogarive bankare	11	3%			0	0,0%
Депозити во банки ко имаат дозвола издадена од НБРСМ/ Depozita në banka të cilat kanë leje të dhënë nga BPRVM	12	60%			0	0,0%
	13					0,0%
Обврзници и други должнички хартии за кои гарантира РСМ/ Letra me vlerë për të cilat garant është RMV	14	80%			0	0,0%
Обврзници и други должнички хартии од вредност кои ги издаваат или за кои гарантираат единиците на локалната самоуправа на РСМ/ Obligacione dhe letra të tjera debitore të emituara me vlerë apo për të cilat në tregun vendor garanton RMV	15	10%			0	0,0%
Обврзници и други должнички хартии со кои се тргува на регулиран пазар на хартии од вредност во РСМ/ Obligacione dhe letra të tjera debitore me vlerë me të cilat tregtohet në tregun e rregulluar të letrave me vlerë në RMV	16	35%			0	0,0%
Обврзници и други должнички хартии со кои не се тргува на регулиран пазар на хартии од вредност, ако нивен издавач е правно лице со седиште во РСМ Obligacione dhe letra të tjera debitore me vlerë me të cilat nuk tregtohet në tregun e rregulluar të letrave me vlerë, nëse emituesi i tyre është person juridik me seli në RMV	17	5%			0	0,0%
Акции со кои се тргува на регулиран пазар на хартии од вредност во РСМ Aksione me të cilat tregtohet në tregun e rregulluar të letrave me vlerë në RMV	18	25%			0	0,0%
Акции со кои не се тргува на регулиран пазар на хартии од вредност, ако нивен издавач е правно лице со седиште во РСМ Aksione me të cilat nuk tregtohet në tregun e rregulluar të letrave me vlerë, nëse botues i tyre është person juridik me seli në RMV	19	5%			0	0,0%

Текст i korrigjuar jozyrtar

Удели во трговски друштва во РСМ/ Pjesëmarrje në shoqëri tregtare në RMV	110	5%			0	0,0%
Удели и акции на инвестициски фондови кои се регистрирани во РСМ/ Pjesëmarrje dhe aksione të фондеве investuese të cilat janë të regjistruara në RMV	111	20%			0	0,0%
Долгорочни обврзници и други долгорочни хартии од вредност чиј издавач е земја членка на ЕУ или земја членка на ОЕЦД/ Obligacione afatgjate dhe letra të tjera afatgjate me vlerë emituesi i të cilave është shtet anëtar i BE-së apo shtet anëtar i OECD-së	112				0	0,0%
Долгорочни обврзници и други долгорочни хартии од вредност чиј издавач е странски правен субјект од земја членка на ЕУ или земја членка на ОЕЦД/ Obligacione afatgjate dhe letra të tjera afatgjate me vlerë, botues i të cilave është subjekt juridik i shtetit anëtar të BE-së apo shtet anëtar i OECD-së	113	20%			0	0,0%
Акции чиј издавач е странско акционерско друштво со кои се тргува на регулиран пазар на хартии од вредност во земјите членки на ЕУ или земјите членки на ОЕЦД/ Aksione emituesi i të cilave është shoqëri e huaj aksionare me të cilat tregtohet në tregun e rregulluar të letrave me vlerë në shtete anëtare të BE-së apo shtetet anëtare në OECD	114				0	0,0%
Удели на инвестициски фондови со кои се тргува на регулиран пазар на хартии од вредност во земја членка на ЕУ или земја членка на ОЕЦД/ Pjesëmarrje në фонде investuese me të cilat tregtohet në tregun e rregulluar të letrave me vlerë në shtet anëtar të BE-së apo shtet anëtar në OECD-së.	115				0	0,0%
Друг вид на вложување согласно правилата на АСО, под услов тоа да не е во спротивност со став (2) од член 89 од ЗСО/ Lloj tjetër i investimit në përputhje me rregullat e AMS, nën kusht që ai të mos jetë në kundërshtim me paragrafin 2 të nenit 89 të LMS	116				0	0,0%
<b>Вложувања кои не се предвидени со Правилникот/ Investime të cilat nuk janë të parashikuara me Rregulloren</b>	<b>II</b>				<b>0</b>	<b>0,0%</b>

Ставка /Zëri	Број/ Numër	Износ/ Vlera
		6
Вкупно дозволени вложувања на средства кои ги покриваат техничките резерви/ Gjithsej investime të lejuara të mjeteve që mbulojnë provigjonet teknike	<b>III</b>	0
Вкупно нето технички резерви/ Gjithsej provigjone teknike neto	<b>IV</b>	0
Резерви за преносни премии/ Provigjone për prime transferuese	IV1	
Резерви за бонуси и попусти/ Provigjone për bonuse dhe lirime	IV2	
Резерви за штети/ Provigjone për dëme	IV3	
Други технички резерви/ Provigjone të tjera teknike	IV4	
Еквализациона резерва/ Provigjon i barazimit	IV5	
Математичка резерва/Provigjoni matematik	IV6	
Разлика (IV-III)/Dallimi (IV-III)/	<b>V</b>	0

**Извештај за вложување на средствата кои ја покриваат математичката резерва - Образец ВМР/ Raport mbi investimin e фондеве që mbulojnë provigjonin matematik - Formulari VMR**

(назив на друштво)/ (emri i shoqërisë)

(период)/(periudha)

(тековна година)/ (viti aktual)

ВМР: Вложувања на средствата кои ја покриваат математичката резерва

VMR: Raport mbi investimin e фондеве që mbulojnë provigjonin matematik

МКД

	Број Numër	Дозволен % (или износ) E lejuar %	Остварен износ/ Shumë e realizuar	Остварен %/ E realizuar %
		1	2	3
<b>Видови дозволени вложувања/ Lloje të investimeve të lejuara</b>	<b>I</b>			
Парични средства во благајна и средства на банкарските сметки/ Mjete të hollash në arkë dhe mjete të llogarive bankare	11	3%		0,0%
Депозити во банки ко имаат дозвола издадена од НБРСМ/ Depozita në banka të cilat kanë leje të dhënë nga BPRMV	12	60%		0,0%
	13			0,0%
Обврзници и други должнички хартии за кои гарантира РСМ/ Letra me vlerë për të cilat garant është RMV	14	80%		0,0%
Обврзници и други должнички хартии од вредност кои ги издаваат или за кои гарантираат единиците на локалната самоуправа на РСМ/ Obligacione dhe letra të tjera debitoare me vlerë me të cilat tregtohet në tregun e rregulluar të letrave me vlerë në RMV	15	10%		0,0%
Обврзници и други должнички хартии со кои се тргува на регулиран пазар на хартии од вредност во РСМ/ Obligacione dhe letra të tjera debitoare me vlerë me të cilat tregtohet në tregun e rregulluar të letrave me vlerë në RMV	16	35%		0,0%
Обврзници и други должнички хартии со кои не се тргува на регулиран пазар на хартии од вредност, ако нивен издавач е правно лице со седиште во РСМ/ Obligacione dhe letra të tjera debitoare me vlerë me të cilat nuk tregtohet në tregun e rregulluar të letrave me vlerë, nëse emituesi i tyre është person juridik me seli në RMV	17	5%		0,0%
Акции со кои се тргува на регулиран пазар на хартии од вредност во РСМ/ Aksione me të cilat tregtohet në tregun e rregulluar të letrave me vlerë në RMV	18	25%		0,0%
Акции со кои не се тргува на регулиран пазар на хартии од вредност, ако нивен издавач е правно лице со седиште во РСМ/ Aksione me të cilat nuk tregtohet në tregun e rregulluar të letrave me vlerë, nëse botues i tyre është person juridik me seli në RMV	19	5%		0,0%
Удели во трговски друштва во РСМ/ Pjesëmarrje në shoqëri tregtare në RMV	110	5%		0,0%
Удели и акции на инвестициски фондови кои се регистрирани во РСМ/ Pjesëmarrje dhe aksione të фондеве investuese të cilat janë të regjistruara në RMV	111	20%		0,0%
Долгорочни обврзници и други долгорочни хартии од вредност чиј издавач е земја членка на ЕУ или земја членка на ОЕЦД/ Obligacione afatgjate dhe letra të tjera afatgjate me vlerë emituesi i të cilave është shtet anëtar i BE-së apo shtet anëtar i OECD-së	112			0,0%
Долгорочни обврзници и други долгорочни хартии од вредност чиј издавач е странски правен субјект од земја членка на ЕУ или земја членка на ОЕЦД / Obligacione afatgjate dhe letra të tjera afatgjate me vlerë, botues i të cilave është subjekt juridik i shtetit anëtar të BE-së apo shtet anëtar i OECD-së	113			0,0%
		20%		

Текст i korrigjuar jozyrtar

Акции чиј издавач е странско акционерско друштво со кои се тргува на регулиран пазар на хартии од вредност во земјите членки на ЕУ или земјите членки на ОЕЦД/ Аксione emituesi i të cilave është shoqëri e huaj aksionare me të cilat tregtohet në tregun e rregulluar të letrave me vlerë në shtete anëtare të BE-së apo shtetet anëtare në OECD	I14			0,0%
Удели на инвестициски фондови со кои се тргува на регулиран пазар на хартии од вредност во земја членка на ЕУ или земја членка на ОЕЦД/ Pjesëmarrje në фонде investuese me të cilat tregtohet në tregun e rregulluar të letrave me vlerë në shtet anëtar të BE-së apo shtet anëtar në OECD-së.	I15			0,0%
Аванси/Avans	I16	20% од м.р.		0,0%
<b>Вложувања кои не се предвидени со Правилникот/ Investime të cilat nuk janë të parashikuara me Rregulloren</b>	<b>II</b>			<b>0,0%</b>

Ставка/Zëri	Број/ Numri	Износ/ Vlera
		4
Вкупно доволени вложувања на средства кои ја покриваат математичката резерва/ Gjithsej investime të lejuara të mjeteve që mbulojnë provigjonet teknike	III	0
Вкупно математичка резерва/ Gjithsej provigjonet matematike	IV	
Разлика (IV-III)/ Dallimi (IV-III)/	V	0

## **ПРИЛОГ 2/ АНЕКСИ 2**

### **UDHËZIM PËR PLOTËSIMIN E RAPORTEVE PËR INVESTIMIN E FONDEVE**

#### **1. Raport mbi investimin e fondeve që mbulojnë provigjonet teknike (formulari VTR)**

Formulari VTR plotësohet nga të gjitha shoqëritë e sigurimeve.

Shoqëria e sigurimeve është e detyruar të plotësojë të gjitha fushat I dhe II në kolonën 2 me shumën për investimet e realizuara të fondeve që mbulojnë provigjonet teknike (pa provigjoni matematikor) ose me zero në kategoritë në të cilat nuk ka investime.

Shoqëria e sigurimeve ka detyrim të plotësojë të gjitha fushat I dhe II në kolonën 3 me shumën për investime të realizuara të fondeve që mbulojnë provigjoni matematik ose me zero në kategoritë në të cilat nuk ka investime. Në versionin elektronik të formularit, kjo kolonë plotësohet automatikisht pas plotësimit të formularit VMR, pra formularëve përkatës VMR të ndjekur nga një numër numerik (VTR-1, VTR-2, etj.) në rast se shoqëria e sigurimeve formon disa fonde fondesh që e mbulojnë atë provigjoni matematik.

Shoqëria e sigurimit ka detyrimin të plotësojë të gjitha fushat I dhe II në kolonën 4 me shumën për investimet e realizuara të fondeve që mbulojnë provigjonet teknike. Në versionin elektronik të formularit, kjo kolonë plotësohet automatikisht si shuma e rreshtave në kolonat 2 dhe 3.

Shoqëria e sigurimit ka detyrimin të plotësojë të gjitha fushat I dhe II në kolonën 5 me treguesit relativë të shumave për investimet e realizuara të fondeve që mbulojnë provigjonet teknike. Në versionin elektronik të formularit, kjo kolonë plotësohet automatikisht, pas plotësimit të kolonës 6.

Shoqëria e sigurimit ka detyrimin të plotësojë fushën III në kolonën 6 me shumën totale të investimit të lejuar të fondeve që mbulojnë provigjonet teknike. Në versionin elektronik të formularit, kjo kolonë plotësohet automatikisht, si shumë e rreshtave në kolonën 4.

Shoqëria e sigurimit ka detyrimin të plotësojë të gjitha fushat IV në kolonën 6 me shumën neto të provigjoneve teknike. Në versionin elektronik të formularit, fusha IV6 në kolonën 6 plotësohet automatikisht pas plotësimit të formularit VMR, domethënë formularëve përkatës VMR të ndjekura nga një numër numerik (VMR-1, VMR-2, etj.) në rast se shoqëria e sigurimeve formon disa fonde aktive të cilat mbulojnë provigjoni matematik.

Shoqëria e sigurimit ka detyrimin të plotësojë fushën V në kolonën 6 me shumën e diferencës midis shumës totale të investimit të lejuar të fondeve që mbulojnë provigjonet teknike dhe totalit të provigjoneve teknike neto. Në versionin elektronik të formularit, kjo kolonë plotësohet automatikisht.

#### **2. RAPORT MBI INVESTIMET E FONDEVE QË MBULOJNË provigjoni MATEMATIK (FORMULARI VMR)**

Formulari VMR plotësohet nga të gjitha shoqëritë e sigurimeve që veçojnë një provigjoni matematik në përputhje me ligjin.

Në rast se shoqëria e sigurimeve krijon disa fonde aktivesh që mbulojnë provigjoni matematik, shoqëria e sigurimeve është e detyruar të plotësojë Formularët e veçantë VMR për çdo fond veç e veç, kështu që çdo Formular VMR pasohet nga një numër numerik (VTR-1, VTR -2 etj.). Ky funksion ofrohet në versionin elektronik të formularit.

Shoqëria e sigurimeve ka detyrimin të plotësojë të gjitha fushat I dhe II në kolonën 2 me shumën për investimet e realizuara të fondeve që mbulojnë provigjoni matematik ose me zero në kategoritë në të cilat nuk ka investime.

Shoqëria e sigurimeve ka detyrimin të plotësojë të gjitha fushat I dhe II në kolonën 3 me treguesit relativë të shumave për investimet e realizuara të aktiveve që mbulojnë provigjonin matematik. Në versionin elektronik të formularit, kjo kolonë plotësohet automatikisht, pas plotësimit të kolonës 4.

Shoqëria e sigurimeve ka detyrimin të plotësojë fushën III në kolonën 4 me shumën totale të investimit të lejuar të fondeve që mbulojnë provigjonin matematik. Në versionin elektronik të formularit, kjo kolonë plotësohet automatikisht, si një shumë e rreshtave në kolonën 2.

Shoqëria e sigurimeve është e detyruar të plotësojë fushën IV në kolonën 4 me shumën neto të provigjonit matematikor. Kjo ka të bëjë me termin nëse duhet të jetë shuma neto e MR ose shuma totale e MR.

Shoqëria e sigurimeve është e detyruar të plotësojë fushën V në kolonën 4 me shumën e diferencës ndërmjet shumës totale të investimit të lejuar të fondeve që mbulojnë provigjonin matematik dhe shumës totale të provigjonit matematik. Në versionin elektronik të formularit, kjo kolonë plotësohet automatikisht.

